



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
REKTORATI
www.uamd.edu.al

Nr. 380 prot

Durrës, më 21.02.2024

VENDIM

Nr. 3, datë 21.02.2024

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të Universitetit, të Rregullores së Universitetit, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 21.02.2024

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së Dr. Alketa Marku referuar shkresës nr.20 prot., datë 08.02.2024 dhe shkresës nr. 20/2 prot., datë 28.01.2024.
2. Ngarkimin e Zv. Rektorit për Çështjet Mësimore Prof.As.Dr. Llambi Prendi dhe Dekanëve të Fakulteteve, në marrjen e masave për ngritjen e grupit të punës për hartimin e një Rregullore Doktorature në nivel Institucional.
3. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve, në rishikimin, për një ndryshim në kalendarin akademik, sipas relacionit të Zv. Rektorit për Çështjet Mësimore Prof.As.Dr. Llambi Prendi.
4. Njohje me shkresën nr. 112/1 prot., datë 23.01.2024 të Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Standarteve të Cilësisë.
5. Ngarkimin e Zv. Rektore për Marrëdhëniet Institucionale Prof.As.Dr. Joniada Mustaraj , për relacion të detajuar për propozimet e fakulteteve për krijimin e grupeve mësimore kërkimore.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Zv. Rektorët,
 - Dekanët e Fakulteteve,
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
KOMISIONI I PËRHERSHËM I GARANTIMIT TË STANDARTEVE DHE CILËSISË

Nr. 112/prot.

Durrës, më: 23 / 1 / 2024

Lënda: Ridërgohet i përmirësuar Raporti Vjetor i Komisionit të Përhershëm i Garantimit të Standarteve dhe Cilësisë, për vitin 2023.

KRYETARES SË SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Kseanela Sotirofski

KËTU

E nderuar znj. Kryetare,

Në zbatim të Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, neni 17, pika 6, bashkëlidhur po ju ripërcjellim të përmirësuar Raportin Vjetor të Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Standarteve dhe Cilësisë së Institucionit, për vitin 2023.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Relit...

KRYETAR

Doc. Dr. Gentian Ruspi

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2023
MBI AKTIVITETIN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR GARANTIMIN E
STANDARTEVE DHE CILËSISË NË UAMD

Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Standarteve dhe Cilësisë në UAMD (në vijim KPGSC) është krijuar dhe funksionon bazuar në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 46, pika 1.

KPGSC, përbëhet nga 7 anëtarë, (6 staf akademik me kohë të plotë dhe 1 student) të miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr.20 datë 11.04.2023. Sa më sipër Komisioni aktual është mandatuar dhe ka filluar punën me këtë përbërje që në prill të 2023. Krahas funksioneve të tij bazuar në legjislacionin në fuqi në vijim të punës është pasur parasysh edhe përvoja e krijuar nga komisionet e mëparshme të mandatuara nga Senati i UAMD-së, që prej muajit Tetor 2017, në nivel institucioni.

Në Statutin e UAMD si dhe në “Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë” përcaktohen funksionet e komisionit në kuadër të zhvillimit të cilësisë përmes përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, miratimit të treguesve të cilësisë në kuadër të “vlerësimit të jashtëm”, si dhe duke respektuar çdo hap të nevojshëm për këtë proces dhe për çdo proces tjetër që lidhet me cilësinë e institucionit tonë arsimor, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë mbledhjeve të Komisionit janë diskutuar një sërë çështjesh të rëndësishme lidhur me standartet dhe cilësinë në fushën akademike, si dhe janë nxjerrë rezultate dhe bërë propozime konkrete. Më konkretisht:

- Janë analizuar përmbajtjet dhe rekomandimet e dala gjatë proceseve të akreditimit të programeve të studimit aktive në UAMD, të kategorizuara sipas cikleve të studimit si dhe është analizuar ecuria e programeve mësimore sipas fazave, në të cilat ato janë në raport me procesin e akreditimit (të akredituara, të paakredituara si dhe në proces akreditimi) si dhe është kërkuar përmbushja e detyrave të lëna për çdo rast.
- Ka vijuar puna për të analizuar planet mësimore të programeve të studimit të ofruara në UAMD për të gjitha ciklet e studimit, të cilat ofrohen në universitetin tonë me qëllimin për të dhënë rekomandimet sipas rastit. KPGSC ka kërkuar (përmes bashkëpunimit dhe komunikimit zyrtar me Rektoren) marrjen e masave për standartizimin e planeve mësimore sipas modelit që KPGSC ka dërguar, model i cili është i miratuar nga ASCAL bazuar në Standartet Shtetërore të Cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit, për ciklin e parë dhe të dytë të

studimeve. Ky model ju është shpërndarë të gjitha njësive për zbatim.

- Nga ana e KPGSC po punohet që të hartohet rregullorja e funksionimit të saj, e cila do të dërgohet në Senatin Akademik për miratim deri në muajin prill të vitit 2024. Në hartimin e kësaj rregulloreje do të synohet bazuar edhe në legjislacionin në fuqi, që KPGSC të ushtrojë funksionin si një strukturë mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standarteve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit në UAMD.
- Bazuar në nenin 2 të *“Rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë”* të UAMD-së, ka nisur puna për mbikëqyrjen e NJSBC-ve në nivel të njësive kryesore dhe në nivel institucional. Deri më tani është analizuar puna e realizuar përmes raporteve të paraqitura në komision nga NJSBC e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit si dhe nga NJSBC e Fakultetit të Studimeve Profesionale dhe vijon puna për NJSBC-të e tjera. Krahas vlerësimeve për punën e bërë nga NJSBC-të nga ana e komisionit po vlerësohen edhe pikat që kanë nevojë për përmirësim dhe do të kërkojë rast pas rasti edhe përmbushjen e rekomandimeve përkatëse. Brenda muajit maj 2024 synohet të përmbyllet vlerësimi për mbikëqyrjen e NJSBC-ve në nivel të njësive kryesore dhe në nivel institucional.
- Është marrë në analizë informacioni i paraqitur në WEB-in e UAMD me qëllim rritjen e mundësisë për t’u njohur me të dhënat dhe informacionet nga ana e të interesuarve për shërbimet që ofron UAMD. Në këtë kuadër KPGSC në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike ka kërkuar parashtrimin e kërkesave për rifreskimin periodik të të dhënave nga secila njësi kryesore dhe njësi bazë në lidhje me kurrikulat, short-biot, përshkrimet e programeve, rezultatet e akreditimeve si dhe pasqyrimin e arritjeve të të gjithë strukturave në WEB-in e UAMD-së. Brenda gjashtëmujorit të parë të 2024, KPGSC do të rivlerësojë masat e marra në këtë drejtim.

Në zbatim të Kodit të Cilësisë dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, Komisioni do të vijojë të ushtrojë funksionet e tij në drejtim të garantimit të standarteve të cilësisë në mënyrë të vazhdueshme, duke bashkëpunuar dhe koordinuar punën me të gjitha strukturat e universitetit në shërbim të rritjes së cilësisë në fushën akademike, si dhe konkurrueshmërisë në nivel kombëtar.

KRYETAR
Doc. Dr. Gentian Ruspi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

Durrës, më 14/2/2024

Lënda: Ne pergjigje te operatoreve turistik per rishikimin e kohezgjatjes se vitit shkollor:

REKTORIT

PROF. DR. KSEANELA SOTIROFSKI

E nderuar Znj. Rektore,

Propozoj një ndryshim në kalendarin akademik që synon tu përgjigjet kërkesave dhe nevojave të operatoreve turistik Durrës. Sektori turistik është një fushë dinamike dhe kërkon fuqi punetore te re me njohuri dhe aftësi praktike. Nryshimi i kalendarit akademik do të lejojë një fleksibilitet më të madh duke shtuar oferten e punes ne sektorin e turizmit.

Ndërhyrjet e Propozuara ne kalendarin akademik:

Bachelor:

- Te eleminohet java e studimit individual 27-31 maj
- Te zevendesohet nje jave mesimi duke bere nje plan te detajuar nga pergjegjesi i departamentit per ditën, auditorin dhe oren e zevendesimit per cdo lektor.
- Sezon Vere/Riprovime/Diplomim propozohet te zhvendoset nga periudha 18-5 korrik ne periudhen 3-14 qeshor

Master:

- Te zevendesohet nje jave mesimi duke bere nje plan te detajuar nga pergjegjesi i departamentit per ditën, auditorin dhe oren e zevendesimit per cdo lektor.
- Sezon Vere/Riprovime/Diplomim propozohet te zhvendoset nga periudha 18-5 korrik ne periudhen 10-23 qeshor

Rezultatet e Propozimit

- Studentët do të kene mundesi te punojne në sektorin turistik duke ju pergjigjur kerkesave te tregut.
- U pergjigjemi propozimit te operatoreve turistik per rishikimin e kohezgjatjes se vitit shkollor
- Krijimi i një lidhje të qëndrueshme dhe të fuqishme me operatoret turistik, duke rritur shanset e studentëve për punësim.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

Zv. Rektor për anën mësimore

Prof.As.Dr. Llambi Prendi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

Durrës, më 14/2/2024

Lënda: Propozim për hartimin e një rregullore doktrature në nivel institucional.

REKTORIT

PROF. DR. KSEANELA SOTIROFSKI

E nderuar Znj. Rektor,

Propozimi për një rregullore doktrature të përgjithshme është e rëndësishme për organizimin dhe menaxhimin e programeve doktrale në UAMD. Kjo rregullore do të jetë e nevojshme për shumë arsye, përfshirë transparencën, standardizimin, mbrojtjen e të drejtave të studentëve, dhe sigurimin e cilësisë së programeve doktrature.

Qellimi i rregullores institucionale:

Percaktimi i rregullave të përgjithshme mbi menyrën e organizimit dhe funksionimit të programeve të studimit të doktrates në njesite baze.

Rezultatet e Propozimit

Një rregullore e përgjithshme siguron konsistencë dhe transparencë në trajtimin e të gjithë individëve në një kontekst institucional, siguron një bazë të përbashkët që mund të jetë e dobishme në trajtimin e çështjeve të ndryshme, ofron një bazë ligjore të qartë që mund të përdoret në rastet e ankesave dhe ndihmon në ndërtimin dhe ruajtjen e identitetit të institucionit

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

Zv. Rektor për anën mësimore
Prof.As.Dr. Llambi Prendi